



## REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

### AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

PA1 Nr.03-251

20.07. 2023

Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 51 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative ark.nr.10-2549/1 datë 20.6.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-2865/4 datë 20.7.2023. Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 23-të mbajtur më 19.7.2023, miratoi si vijon:

#### **Aktvendim për ndërmarrje të masës – paralajmërim publik**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip, për shkelje të kryer nga neni 51 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), të mënyrës që transmetuesi në kuadër të shërbimit programor në radio transmetuar më 2. 6.2023, nuk ka ofruar informacionin që duhet t'i vihet në dispozicion shfrytëzuesve.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-2549/1 datë 20.6.2023, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip, në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi të harmonizon punën e tij me dispozitat nga LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim të përcaktimit nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe si ditë për miratimin e tij llogaritet dita e certifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

#### **A r s y e t i m**

Agjencia në bazë të nenit 29 nga LSHMAAV është kompetente të kryen mbikëqyrje administrative për punën e botuesve të medias në aspekt të harmonizimit të punës së tyre me kushtet e përcaktuara në Ligjin për media, LSHMAAV dhe dispozitave miratuar në bazë të këtij Ligji.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë – aktvendim për vërejtje publike në pajtueshmëri me këtë Ligj, në rastet kur kemi shkelje të dispozitave nga LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve përcaktuar në lejen dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 51 paragrafi (1) nga LSHMAAV, ofruesi i shërbimeve audio dhe audiovizive duhet shfrytëzuesve tu mundëson qasje direkte, të drejtpërdrejtë dhe të përhershme, së paku për të dhënat në vijim: emrin e ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audioviziv, përkatësisht emrin, shenjën mbrojtëse ose shenjën e shkurtuar të identifikimit (avizo, logon dhe të ngjajshme); adresën e selisë të ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audiovizuele; të dhëna për kontakt me ofruesin e shërbimit mediatik audio ose audioviziv (numër telefoni, adresë të postës elektronike e-mail dhe/ose ueb faqes, personin për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe nëse është e mundur dhe për trupin rregullator kompetent.

Në kuadër të kompetencave të veta ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore më 20.6.2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative (monitorim) të shërbimit programor në radio të SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip, transmetuar më 2.6.2023, në nivel shtetëror, nga ku u konstatua shkelje e nenit 51 paragrafi (1) nga LSHMAAV. Gjegjësisht, nga mbikëqyrja u konstatua se më 2.6.2023, shërbimi programor në radio i SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip, nuk ka ofruar informacionin që duhet tu vihet në dispozicion përdoruesve, respektivisht nuk ka mundësuar për shfrytëzuesit e tij qasje direkte, të

drejtpërdrejtë dhe të përherëshme, së paku për të dhënat në vijim: emrin e plotë të ofruesit të shërbimit audioviziv; adresën e selisë të ofruesit të shërbimit audioviziv; të dhëna për kontakt (numër telefoni, adresë të postës elektronike e-mail dhe/ose të ueb faqes; personi përgjegjës për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe për trupin rregullator kompetent.

Shkelja nga pika 1 i këtij Aktvendimi, është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-2549/1 datë 20.6.2023, e cila është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip më 23.6.2023, dërgoi Shkresë ark.nr.10-2549/2 datë 23.6.2023, me të cilën i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-2549/1 datë 20.6.2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave nga LSHMAAV. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga ana e transmetuesit, për të cilën SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip, dorëzoi deklaram me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave nga LSHMAAV, me Nr.y në ark.10-2549/3 datë 12.7.2023. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 19.7.2023, pasi shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe deklaratën e dorëzuar me shkrim, dhe konkludoi se ndaj SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip t'i shqiptohet masë - paralajmërim publik.

Rrjedhimisht nga sa më lartë, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 51 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe 14 nga Udhëzimi për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative ark.nr.10-2549/1 datë 20.6.2023, dhe Konkluzionin ark.nr.02-2865/4 datë 20.7.2023, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e sotme mbajtur më 19.7.2023, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip dhe e urdhëron që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, të harmonizon punën e tij me dispozitat nga LSHMAAV. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim të përcaktimit nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit..

Në bazë të gjithë kësaj që është theksuar më lartë, u mor aktvendim si në dispozitiv.

#### **Shtojcë (1):**

1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-2549/1 datë 20.6.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.